



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HERMANN GMEINER"

Nr. 791 .prot.

Tiranë, më 14.12.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë,; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, dt.27.05.202, i ndryshuar "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Shkolla "Hermann Gmeiner" Tiranë, ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet :

- **1 (një) mësimdhënës të teorisë profesionale Teknologji Informacioni dhe Komunikimi**
- **1 (një) mësimdhënës i teorisë profesionale Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, mësues zëvendësues (leje lindje), deri më datë 14.06.2024**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posacme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të kërkuar;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

- 2. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- 3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre.
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
- 4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 22.12.2023

